



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 9 janar 2018
Nr. ref.: AGJ 1182/18

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI97/16

Parashtrues

“IKK Classic”

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. 15/2016,
të 16 marsit 2016**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga kompania e sigurimit IKK Classic (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilën e përfaqësojnë avokatët Besnik Nikqi dhe Visar Morina nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [E. Rev. 15/2016] e Gjykatës Supreme të Kosovës të 16 marsit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 shkurt 2016, Gjykata Kushtetuese nxori Aktgjykimin në rastin KI135/14, parashtrues *IKK Classic*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit E. Rev. nr. 21/2014 të Gjykatës Supreme të Kosovës të 8 prillit 2014 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i Gjykatës në rastin nr. KI135/14). Gjykata e shpalli të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 21/2014] të 8 prillit 2014 për shkak se kishte konstatuar se ky Aktgjykim ishte nxjerrë në kundërshtim me të drejtën për një vendim të arsyetuar siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
6. Më 7 prill 2016, Gjykata Supreme njoftoi Gjykatën për Aktgjykimin e saj të ri, respektivisht të dytë [E. Rev. 15/2016] të 16 marsit 2016, të nxjerrë në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14.
7. Më 25 prill 2016, parashtruesi i kërkesës gjithashtu e informoi Gjykatën për Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Supreme, duke pretenduar se ai: a) përsëri përbën shkelje të së drejtës së tij për një vendim të arsyetuar dhe b) nuk ka zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14.
8. Më 29 prill 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës se në bazë të Kushtetutës, ajo vendos vetëm çështjet e ngritura në mënyrë ligjore nga palët e autorizuara dhe se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë një kërkesë të re në Gjykatë.

9. Më 22 qershor 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën e re në Gjykatë, të regjistruar si kërkesa nr. KI97/16 duke pretenduar se Aktgjykimi i ri, respektivisht, i dytë i Gjykatës Supreme [E. Rev. 15/2016] i 16 marsit 2016, i nxjerrë në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14, vazhdon ta shkelë të drejtën e tij në vendim të arsyetuar.
10. Më 12 korrik 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.
11. Më 29 gusht 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.
12. Më 2 nëntor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili dha dorëheqje nga pozita e gjyqtarit të Gjykatës më 9 shtator 2016. Përbërja e Kolegjit shqyrtues mbeti e pandryshuar.
13. Më 4 dhjetor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 24 nëntor 2008, D.H., i siguruari i parashtruesit të kërkesës, ka pësuar lëndime të rënda në një aksident trafiku të shkaktuar nga B.L., shfrytëzues i sigurimit në kompaninë e sigurimeve "SIGMA" në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: SIGMA). D.H., ka marrë trajtim mjekësor në Republikën Federale të Gjermanisë në shumë prej 18.985,36 Euro, e cila ishte paguar nga parashtruesi i kërkesës.
15. Më 3 shkurt 2009, SIGMA dhe D.H. arritën një marrëveshje jashtëgjyqësore, ku ky i fundit u kompensua nga SIGMA në shumën prej 2,729 Euro. Bazuar në këtë marrëveshje, SIGMA konsideroi se i kishte përmbushur të gjitha detyrimet e saj në lidhje me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të 24 nëntorit 2008, duke përfshirë shumën prej 18.985,36 Euro të paguar nga parashtruesi i kërkesës si kompani e sigurimit të D.H.
16. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga SIGMA që të kompensohet me shumën e lartpërmendur. Parashtruesi i kërkesës kërkoi që SIGMA t'i kompensojë shpenzimet mjekësore për trajtimin e D.H., në bazë të Rregullës 3 të Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë së Palës së Tretë të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës.
17. Parashtruesi i kërkesës dhe SIGMA nuk arritën marrëveshje sa i përket çështjes së kompensimit, prandaj, i adresuan paditë e tyre përkatëse në gjykatat e rregullta.
18. Gjykata e atëhershme Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, aprovoi padinë e parashtruesit të kërkesës si të bazuar dhe urdhëroi që SIGMA t'ia kompensojë parashtruesit të kërkesës shumën prej 18.985,36 Euro. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit konfirmoi vendimin e Gjykatës Ekonomike të

Qarkut, duke arsyetuar se pala e paditur (SIGMA) duhet t'ia kompensojë parashtruesit të kërkesës shumë prej 18.985,36 Euro.

19. Më 4 mars 2014, SIGMA parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar se ka përmbushur detyrimet e saj me pagesën e dëmit material dhe jomaterial ndaj të sigurve D.H., dhe se, parashtruesi i kërkesës, si një kompani e huaj e sigurimeve do të kishte të drejtë të kompensimit *vis-a-vis* kompanive të sigurimeve të Kosovës vetëm përmes marrëveshjes dypalëshe midis Republikës së Kosovës dhe shtetit të kompanisë së huaj të sigurimit.
20. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E. Rev. nr. 21/2014 i 8 prillit 2014], aprovoi si të bazuar kërkesën për revizion të SIGMA dhe konstatoi se gjykatat e shkallës më të ulët kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe, se SIGMA është liruar nga kompensimi i shumës që parashtruesi i kërkesës pretendonte.
21. Më 3 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatë kërkesë, duke kontestuar Aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Supreme. Kjo kërkesë ishte regjistruar si rasti nr. KI135/14 (shih Aktgjykimin në rastin KI135/14, parashtruesi i kërkesës *IKK Classic*, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 21/2014 të 8 prillit 2014).
22. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se ky Aktgjykim i Gjykatës Supreme ishte nxjerrë në shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës pretendoi, ndër të tjera, se Aktgjykimi i kontestuar Gjykatës Supreme karakterizohet me mungesën e arsytimit përkitazi me pretendimet e tij thelbësore.
23. Më 9 shkurt 2016, Gjykata përmes Aktgjykimit në rastin KI135/14, konstatoi shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, për shkak se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk ishte i arsyetuar.
24. Aktgjykimi i Gjykatës në rastin nr. KI135/14 kishte konstatuar se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 121/2014] i 8 prillit 2014, nuk i kishte përmbushur standardet e një vendimi të arsyetuar, dhe përmes Aktgjykimit të saj [KI135/14], Gjykata kishte përmbledhur pretendimet e parashtruesit të kërkesës të cilat i përcaktoi si thelbësore dhe të cilat rrjedhimisht, kërkojnë përgjigje nga Gjykata Supreme, me qëllim që të respektohen të drejtat e parashtruesit të kërkesës dhe të përmbushen standardet e së drejtës për një vendim të arsyetuar.
25. Në të vërtetë, me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14, ishte konstatuar që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 121/2014] i 8 prillit 2014, nuk kishte adresuar pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës si në vijim: “(i) nëse marrëveshja jashtëgjyqësore e lidhur në mes të SIGMA dhe të sigurve D. H. ia ka mohuar të drejtën parashtruesit për kompensim,

(ii) se si kompensimi i paguar nga SIGMA ndaj të sigurvearit D. H. e liroi atë t'ia paguajë kompensimin parashtruesit të kërkesës, si dhe, (iii) se si marrëveshja jashtëgjyqësore në mes të SIGMA-s dhe D. H., mund të prekë të drejtat e parashtruesit të kërkesës, ku është e qartë, se ky i fundit nuk ishte palë në këtë marrëveshje". (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI135/14, parashtrues IKK Classic, Aktgjykim i 9 shkurtit 2016, para. 51).

26. Më 16 mars 2016, pas Aktgjykimit të Gjykatës në rastin nr. KI135/14, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin e ri, respektivisht, të dytë për rastin, [Aktgjykimi E. Rev. nr. 15/2016] të 16 marsit 2016, përmes të cilit përsëriti gjetjet e Aktgjykimit të parë [E. Rev. nr. 21/2014] të 8 prillit 2014, duke vendosur se kërkesa për revizion e SIGMA është e bazuar; dhe se, vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët, me të cilat ishte konstatuar se SIGMA është e detyruar t'i kompensojë parashtruesit të kërkesës shumën prej 18.985,36 Euro, duhet të refuzohen si të pabazuara.
27. Duke iu përgjigjur pretendimeve thelbësore të parashtruesit të kërkesës, siç ishin përmbledhur edhe me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14, Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj të dytë [E. Rev. nr. 15/2016] i 16 marsit 2016] u përgjigj përmes dy paragrafëve në vijim:

"[...] marrëveshja jashtëgjyqësore e lartpërmendur e lidhur në mes të KS "Sigma" dhe të sigurvearit të paditësit, ia ka mohuar të drejtën e paditësit për regresim të shpërblimit të dëmit, të cilin ia ka paguar të sigurvearit të saj D. H., nga se i sigurveari i paditësit drejtëpërdrejtë nga e paditura ka realizuar shpërblimin e dëmit sipas kësaj marrëveshjeje, sipas të cilës ai ka hequr dorë nga të gjitha kërkesat për këtë dëm, të tanishëm dhe të ardhshëm. Kështu që raporti juridik në mes të paditësit dhe të sigurvearit të saj D.H. mbetet raport juridik vetëm në mes tyre, në bazën e të cilit edhe paditësi ka paguar dëmshpërblim, pa e ditur se i sigurveari i saj ka realizuar nga KS "Sigma" dëmshpërblimin. Kjo i bie që i sigurveari i paditësit, është kompensuar dy herë, në çka nuk ka të drejtë.

Nëse i sigurveari i paditësit të mos kishte realizuar direkt dëmshpërblimin nga e paditura, ndaj të paditurës, paditësi përkitazi me regresimin e borxhit për aq sa i ka paguar të sigurvearit të saj, padyshim do të kishte të drejtë, sepse mundësia e regresivit është e paraparë me nenin 939 par.,1 të Ligjit të lartpërmendur".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
29. Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [E. Rev. 15/2016] i 16 marsit 2016 vazhdon të karakterizohet nga mungesa e arsytimit në lidhje me pretendimet e tij thelbësore; dhe se Gjykata Supreme nuk arriti të japë arsytimin për konstatimet kryesore dhe çështjet e ngritura nga Aktgjykimi i Gjykatës në rastin nr. KI134/15,

posaçërisht, se si përmbushja e detyrimeve nga SIGMA ndaj të sigurvearit D.H., përmes marrëveshjes jashtëgjyqësore, i pamundëson parashtruesit të kërkesës realizimin e së drejtës së tij për kompensim.

30. Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës konsideron se në rastin e tij, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është në kundërshtim me praktikën e vet gjyqësore në situata të ngjashme. Parashtruesi i kërkesës argumenton se praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në situata të ngjashme tregon që marrëveshjet e dëmshpërblimit prodhojnë efekte juridike ‘*inter-partes*’ dhe jo ‘*erga omnes*’, rrjedhimisht, të drejtat dhe interesat e palëve të treta nuk mund të preken me këto marrëveshje. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, parashtruesi i kërkesës i referohet tri vendimeve të Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 62/2014; E. Rev. nr. 48/2014; dhe E. Rev. nr. 14/2015].

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

33. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.

34. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u referuar në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih Gjykata Kushtetuese rasti nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, në paragrafin 14).
35. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës, pasi që është palë e autorizuar, që e konteston aktin e një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [E. Rev. 15/2016] të 16 marsit 2016, dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.

36. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

*Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]*

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

*Neni 49
[Afatet]*

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”.

37. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka specifikuar qartë të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, të cilat pretendohet se janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe e ka parashtruar kërkesën brenda afatit prej katër (4) muajsh të paraparë me nenin 49 të Ligjit.
38. Gjykata në fund vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1) (d) të Rregullores së punës. Gjykata më tej thekson se nuk është e papranueshme në asnjë bazë tjetër. Prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme (shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykimi i 9 korrikut 2012, § 144).

Meritat e kërkesës

39. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës kryesisht pretendon se me Aktgjykimin e dytë, respektivisht Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, janë shkelur të drejtat e tij për një vendim të arsyetuar, sepse nuk i ka adresuar argumentet e tij thelbësore, duke përfshirë edhe ato që janë kërkuar me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14, për më tepër që është një Aktgjykim i cili bie në kundërshtim me praktikën gjyqësore të vet Gjykatës Supreme.
40. Gjykata fillimisht do të shqyrton meritat e kërkesës sa i përket nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

41. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, që përcakton:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

42. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 6.1 (E drejta për një proces të rregullt), të KEDNJ-së, që përcakton:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”

43. Gjykata thekson se e drejta për një vendim të arsyetuar garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe zbatimi i saj, është interpretuar nga Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) përmes praktikës së saj gjyqësore. Gjykata bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Rrjedhimisht, sa i përket interpretimit të pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

(i) Parimet e përgjithshme mbi të drejtën për një vendim të arsyetuar siç është zhvilluar me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së

44. Gjykata rikujton që e drejta për një gjykim të drejtë përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar. GJEDNJ ka konstatuar se, sipas praktikës së saj të vendosur gjyqësore, e cila pasqyron parimet të lidhur me administrimin e duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet t'i theksojnë në mënyrë adekuate arsyet në të cilat ato bazohen. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Tatishvili kundër Rusisë*, nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, § 58; *Hiro Balani kundër Spanjës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 18064/91, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, § 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, kërkesa nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, § 42).
45. Përveç kësaj, përderisa GJEDNJ-ja gjithashtu ka konstatuar se autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar se sistemet e tyre gjyqësore janë në përputhje me kërkesat e nenit 6 (1) të KEDNJ-së, gjykatat e tyre duhet “t'i tregojnë me qartësi të mjaftueshme bazat që kanë shërbyer për nxjerrjen e vendimeve të tyre”. (Shih rasti i

GJEDNJ-së, *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim, i 16 dhjetorit 1992, § 33).

46. Në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së theksohet se funksioni thelbësor i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë. (shih *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së *Hirvisaari kundër Finlandës*, kërkesa nr. 49684/99, 27 shtator 2001 § 30; *Tatishvili kundër Rusisë*, kërkesa nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, § 58; dhe *Suominen kundër Finlandës*, kërkesa nr. 37801/97, Aktgjykimi i 1 korrikut 2003, § 37).
47. Megjithatë, edhe pse GJEDNJ pohon se neni 6, paragrafi 1, obligon gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, ajo gjithashtu ka konstatuar se kjo nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994, § 61; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, kërkesa nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, § 42).
48. Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. (rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, § 29, *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, § 27, dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, *Ibidem* § 42).
49. Për shembull, në hedhjen poshtë të një ankese, një gjykatë apeli mundet në parim, thjesht të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të gjykatës më të ulët. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, § 26 dhe *Helle kundër Finlandës*, Aktgjykimi i 19 dhjetorit 1997, §§ 59, 60). Autoriteti ose gjykata më e ulët duhet të japin arsye të tilla që t'u mundësojnë palëve që të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës. (Rasti i GJEDNJ-së *Hirvisaari kundër Finlandës*, kërkesa 49684/99, Aktgjykimi i 27 shtatorit 2001, § 30).
50. Megjithatë, GJEDNJ ka gjithashtu ka vërejtur se, edhe pse gjykatat kanë liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e argumenteve në një rast të veçantë dhe në pranimin e provave në mbështetje të parashtrësive të palëve, një gjykatë vendore është e detyruar të justifikojë aktivitetet duke dhënë arsye për vendimet e saj. (Rasti i GJEDNJ-së shih *Suominen kundër Finlandës*, kërkesa nr. 37007/97, 1 korrik 2003 § 36).
51. Prandaj, përderisa nuk është e nevojshme që gjykata të merret me çdo pikë të ngritur në argument (shih gjithashtu *Van de Hurk kundër Holandës*, *Ibidem*, § 61), argumentet thelbësore të parashtrësive të kërkesës duhet të adresohen. (Rastet e GJEDNJ-së *Buzescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 61302/00, Aktgjykimi i 24 majit 2005, § 63; *Pronina kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006, § 25). Po ashtu, dhënia e një arsyeje

për një vendim që nuk është mirë e bazuar në ligj, nuk do të përmbushë kriteret e nenit 6.

52. Në fund, Gjykata gjithashtu i referohet praktikës së saj gjyqësore ku ajo konsideron që arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe reflektimeve kur të merren parasysh provat e propozuara nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës nga ana tjetër. Aktgjykimi i Gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre. (Gjykata Kushtetuese: rasti nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, § 61, dhe nr. KI135/14, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, § 58).

(ii) Zbatimi i parimeve të përmendura më lart në rastin e tanishëm

53. Parashtruesi i kërkesës pretendon se edhe me Aktgjykimin e dytë të Gjykatës Supreme [E. Rev. 15/2016 të 16 marsit 2016], nuk arrin të kuptojë pse i mohohen të drejtat e tij për kompensim, duke marrë parasysh që pretendimet thelbësore të tij nuk janë adresuar dhe as nuk janë arsyetuar me Aktgjykimin e lartcekur.
54. Përgjatë tërë sistemit të rregullt gjyqësor, parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se duke plotësuar detyrimet ndaj të sigurvearit D. H., ai ka fituar të drejtën e subrogimit nga SIGMA (kalimi i të drejtave të sigurvearit ndaj personit përgjegjës në siguruesin), siç përcaktohet me Ligjin për Marrëdhëniet Detyimore (Ligji nr. 04/L-77 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, publikuar në Gazetën Zyrtare më 19 qershor 2012). Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka pretenduar përgjatë tërë sistemit të rregullt gjyqësor se marrëveshja jashtëgjyqësore e arritur mes SIGMA dhe D. H., nuk i përjashton të drejtat e parashtruesit të kërkesës për subrogim dhe se kjo marrëveshje jashtëgjyqësore nuk mund të cenojë të drejtat e parashtruesit të kërkesës, pasi që ka efekt ligjor ‘*inter-partes*’ dhe jo ‘*erga-omnes*’.
55. Gjykata përmes Aktgjykimit të saj në rastin KI135/14, i ka pranuar këto pretendime të parashtruesit si thelbësore dhe që kërkojnë të adresohen dhe arsyetohen. Gjykata vuri në dukje në mënyrë specifike se në bazë të natyrës dhe rrethanave specifike të rastit, çështjet e mëposhtme thelbësore do të duhej të adresoheshin, për të pasur një vendim që përmbush standardet e të drejtës për një vendim të arsyetuar, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së: “(i) nëse marrëveshja jashtëgjyqësore e lidhur në mes të SIGMA dhe të sigurvearit D. H., ia ka mohuar të drejtën parashtruesit për kompensim, (ii) se si kompensimi i paguar nga SIGMA ndaj të sigurvearit D. H. e liroi atë t’ia paguajë kompensimin parashtruesit të kërkesës, si dhe, (iii) se si marrëveshja jashtëgjyqësore në mes të SIGMA-s dhe D. H. mund të prekë të drejtat e parashtruesit të kërkesës, ku është e qartë, se ky i fundit nuk ishte palë në këtë marrëveshje”. (Shih Aktgjykimin e Gjykatës KI135/14, § 51).
56. Gjykata vëren se Gjykata Supreme, në Aktgjykimin e saj të dytë [E. Rev. 15/2016] të 16 marsit 2016, konstatoi që “Gjykata Kushtetuese, (...) ka kthyer

në rishqyrtim aktgjykimin e lartpërmendur në Gjykatën Supreme të Kosovës, (...) me arsyetim që Gjykata nuk ka arritur të shpjegojë qartë disa çështje të rëndësishme”, të cilat, Aktgjykimi i kontestuar i numëron një nga një, por në të cilat nuk përgjigjet.

57. Në të vërtetë, në përpjekje për të adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14, Gjykata Supreme vëren se: *“i siguruari D. H. është kompensuar dy herë nga parashtruesi dhe nga “SIGMA” dhe se: “paditësi ka paguar dëmshpërblim, pa e ditur se i siguruari i saj ka realizuar dëmshpërblimin nga KS “Sigma”. Prandaj, në Aktgjykimin e kontestuar konsiderohet që “i siguruari i paditësit, është kompensuar dy herë, në çka nuk ka të drejtë”. Gjykata Supreme pastaj thekson që: “Nëse i siguruari i paditësit të mos kishte realizuar direkt dëmshpërblimin nga e paditura, ndaj të paditurës, paditësi përkitazi me regresimin e borxhit për aq sa i ka paguar të siguruarit të saj pa dyshim do të kishte të drejtë”.*
58. Prandaj, duket se Gjykata Supreme konsideron se është e padrejtë që i siguruari D. H., është kompensuar dy herë dhe se, nëse D.H. nuk do të ishte kompensuar nga SIGMA, atëherë parashtruesi i kërkesës do të kishte të drejtën e kompensimit. Megjithatë, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk i adreson pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës dhe nuk jep arsyetim adekuat pse janë mohuar të drejtat e tij për kompensim.
59. Më konkretisht, përderisa Aktgjykimi i Gjykatës Supreme pohon se parashtruesi i kërkesës nuk ka të drejtën e kompensimit, pavarësisht faktit se e ka kompensuar të siguruarin D.H., gjë që vetë Gjykata Supreme pohon se nuk është e drejtë, prapëseprapë nuk i jep parashtruesit të kërkesës përgjigje ndaj pretendimeve të tij thelbësore dhe nuk bën arsyetimin e mjaftueshëm vendimit, në veçanti duke pasur parasysh praktikën e saj gjyqësore.
60. Në të vërtetë, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk ka shpjeguar pse parashtruesi i kërkesës nuk ka fituar të drejtën e subrogimit dhe as nuk i është përgjigjur pretendimeve që me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14 janë përcaktuar si thelbësore, përkatësisht, se si kompensimi i paguar nga SIGMA tek i siguruari D. H., e liroi të parin nga kompensimi i parashtruesit të kërkesës; dhe se si marrëveshja jashtëgjyqësore e arritur ndërmjet SIGMA dhe D.H., mund të ndikojë në të drejtat e parashtruesit të kërkesës, kur është e qartë se ky i fundit nuk ishte palë në atë marrëveshje.
61. Gjykata përsërit, siç ka bërë në Aktgjykimin e saj në rastin nr. KI135/14, (paragrafi 47), se nuk është detyrë e saj që të shqyrtojë nëse Gjykata Supreme e ka interpretuar drejt ligjin e aplikueshëm (ligjshmëria), por të shqyrtojë nëse Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat dhe liritë individuale të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). (Shih, gjithashtu Gjykata Kushtetuese rasti nr. KI72/14, parashtruesja e kërkesës *Besa Qirezi*, Aktgjykim i 4 shkurtit 2015, § 65; dhe rasti i GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, § 28).
62. Për më tepër në këtë pikë, Gjykata përsërit që (shih gjithashtu Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14, paragrafi 48), si rregull i përgjithshëm, vërtetimi i fakteve të rastit dhe interpretimi i ligjit janë ekskluzivisht çështje

për gjykatat e rregullta, konstatimet dhe konkluzionet e të cilave në këtë drejtim janë detyruese për Gjykatën. Megjithatë, kur vendimi i gjykatës së rregullt është qartazi arbitrar, Gjykata mund dhe duhet ta shqyrtojë atë. (shih GJEDNJ *Sisojeva dhe të tjerët kundër Letonisë*, kërkesa nr. 60654/00, Aktgjykimi i 15 janarit 2007, § 89).

63. Për më tepër, nuk është detyrë e Gjykatës të vendosë se cila do të ishte mënyra më e përshtatshme për gjykatat e rregullta që të merren me argumentet e ngritura. Megjithatë, Gjykata konsideron që Gjykata Supreme, duke injoruar krejtësisht çështjen, edhe pse ishte specifike, relevante dhe e rëndësishme, nuk i kishte plotësuar detyrimet e saj sipas nenit 6, para. 1 të KEDNJ-së. (Shih rasti i GJEDNJ-së *Pronina kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 63566/00, Aktgjykimi i 18 korrikut 2006, § 25).
64. Prandaj, duke marrë parasysh vërejtjet e mësipërme dhe procedurën në tërësi, Gjykata konsideron që Aktgjykimi i dytë i Gjykatës Supreme, përkatësisht [E. Rev.15/2016] i 16 marsit 2016, nuk ka korrigjuar shkeljet e konstatuara me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14 dhe nuk i ka dhënë arsye të mjaftueshme parashtruesit të kërkesës se përse mohohen të drejtat e tij për kompensim në rrethanat e këtij rasti specifik. Rrjedhimisht, ai nuk i ka plotësuar kriteret e drejtësisë siç kërkohet me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih rasti i GJEDNJ-së *Grădinar kundër Moldavisë*, kërkesa nr. 7170/02, Aktgjykimi i 8 prillit 2008, § 115).
65. Gjykata konsideron se dështimi i Gjykatës Supreme për të dhënë përgjigje të qarta dhe të plota që kanë të bëjnë me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për kompensim, siç është përcaktuar gjithashtu nga gjykatat e instancës më të ulët, paraqet shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për t'u dëgjuar dhe të drejtës për një vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (Shih Aktgjykimi i Gjykatës, § 59).
66. Gjykata vëren se GJEDNJ gjithashtu kishte konstatuar shkelje të nenit 6.1 të KEDNJ-së (në *Hiro Balani kundër Spanjës*), ku parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar një kërkesë, duke kërkuar përgjigje konkrete dhe të shpejtë. Gjykata nuk arriti të japë një përgjigje, duke e bërë kështu të pamundur për të verifikuar nëse thjesht e kishte neglizhuar këtë çështje, ose kishte për qëllim ta hidhte poshtë atë parashtrësë dhe nëse po, cilat ishin arsyet për ta hedhur poshtë atë. (Shih gjithashtu Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI135/14, § 56).
67. Në pajtim me këtë, duhet të konstatohet se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [E. Rev. 15/2016] të 16 marsit 2016, nuk ka plotësuar kriteret e një "gjykimi të drejtë" sipas nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar.
68. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se ky përfundim ekskluzivisht ka të bëjë me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme nga këndvështrimi i mjaftueshmërisë së arsyetimit që ndërlihet me pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

69. Në fund, Gjykata konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e parashtruesit të kërkesës sa i përket nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, posaçërisht pasi që ka konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 të KEDNJ-së.

Përfundim

70. Në përfundim, Gjykata konstaton se duke mos marrë parasysh dhe duke mos e arsyetuar të drejtën e pretenduar të parashtruesit të kërkesës për kompensim, për më tepër që nuk i ka adresuar konstatimet e Aktgjykimit të Gjykatës në rastin nr. KI135/14, me Aktgjykimin e dytë të Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 15/2016] të 16 marsit 2016, është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së. Si rezultat i kësaj shkeljeje, parashtruesi i kërkesës u privua nga e drejta e tij për vendim të arsyetuar.
71. Si përmbledhje, në pajtim me rregullin 74 (1) të Rregullores së punës, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 15/2016] i 16 marsit 2016 shpallet i pavlefshëm dhe çështja i kthehet Gjykatës Supreme për rishqyrtim.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113 (7) dhe 116 (1) të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 56 (1), 63 (1) (5) dhe 74 (1) të Rregullores së punës, më 4 dhjetor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- III. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 15/2016] të 16 marsit 2016;
- IV. TA KTHEJË Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 15/2016] të 16 marsit 2016 për rishqyrtim në pajtim me këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese;
- V. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtimit me këtë urdhër;
- VI. TA URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për ta zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës;
- VII. TË NJOFTOJË që ky Aktgjykim t'u komunikohet palëve;
- VIII. TA PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IX. TË DEKLAROJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani
Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Artë Rama-Hajrizi
Artë Rama-Hajrizi